

**PROTOKOLL
NDËRMJET
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS
SË KOSOVES
DHE
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS
SË MAQEDONISE
PËR NDJEKJEN E MENJËHERSHME NDËRKUFITARE**

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës,

dhe

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë

këtej e tutje të quajtura "Palët Kontraktuese"

- Në bazë të Marrëveshjes në mes të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim policor, të nënshkruar 03.12.2009 në Prishtinë,

- në aspiratat e tyre për zhvillimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale në frymëzimin e miqësisë ekzistuese dhe bashkëpunimit ndërmjet Ministrive të dy shteteve,

- dëshirës së përbashkët për të parandaluar në mënyrë efektive rreziqet ndërkufitare ndaj sigurisë publike dhe krimin e organizuar ndërkombëtarë, përmes një partneriteti të sigurisë,

- me qëllim të luftimit të efektshëm të krimit ndërkufitar dhe migrimit ilegal, në mbështetje të aktiviteteve të koordinuara dhe

- duke synuar për të nxitur edhe më tej bashkëpunimin e ndërsjellët të policisë dhe policisë kufitare,

Bien dakord për:

Neni 1

Fusha e zbatimit të Protokollit

Fusha e Protokollit ndërmjet Ministrisë së punëve të brendshme e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së punëve të brendshme e Republikës së Kosovës për ndjekjen e menjëhershme ndërkufitare (në tekstin e mëtejme i referuar si Protokoll) do të jetë për të përcaktuar me saktësi kushtet e zbatimit (implementimit) të ndjekjes se menjëhershme ndërkufitare, specifikimin e veprave penale për të cilat ndjekja e menjëhershme ndërkufitare do të lejohet, trajtimin e personit të privuar nga liria gjatë ndjekjes se menjëhershme, kufizimin hapësinor dhe kohor gjatë ndjekjes se menjëhershme ndërkufitare, mbajtja e armëve të shërbimit dhe përdorimi i mjeteve shtrënguese, procedurat që duhet ndjekur pas përfundimit të ndjekjes se menjëhershme, ndjekja e menjëhershme ndërkufitare për qëllime të tjera dhe kushtet e

tjera që duhet të përmbushen për zbatimin (implementimin) efikas dhe efektiv të ndjekjes të menjëhershme ndërkufitare.

Neni 2

Autoritetet Kompetente

Autoritetet kompetente sipas këtij Protokoll janë:

- (a) Për Ministrinë e punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë:
 - Byroja për siguri publike
- (b) Për Ministrinë e punëve të brendshme të Republikës së Kosovës:
 - Drejtoria e përgjithshme e policisë së Kosovës

Neni 3

Zonat kufitare

Zonat kufitare të përfshirë nga ky Protokoll duhet të jenë zonat kufitare taksore ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës.

Neni 4

Pranueshmëria e ndjekjes së menjëhershme ndërkufitare

(1) Autoritetet kompetente të një Pale Kontraktuese për ndjekje brenda shtetit të tyre të një individit ose individëve të kapur në aktin e kryerjes apo të cilët kanë qenë **pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale të cilët mund të jenë subjekt i kërkesës për ekstradim nga Pala tjetër Kontraktuese** do t'u lejohet të vazhdojnë ndjekjen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese pa miratimin e saj paraprak, kur merret parasysh urgjenca e situatës, autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese mund të mos të njoftohen paraprakisht ose kur këto autoritete nuk janë në gjendje për të arritur në vend me kohë për të marrë përsipër ndjekjen Shtojca 1 (specifikimi i veprave penale për ekstradim)

(2) E njëjta gjë do të zbatohet kur personi që ndiqet është i arratisur nga paraburgimi ose është në vuajtje të dënimit me heqje të lirisë për veprën penale nga paragrafi 1 të këtij neni.(3).

(3) Policët që kryejnë ndjekjen e menjëhershme do ta njoftojnë autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës zhvillohet ndjekja e menjëhershme dhe duhet të bëhet jo më vonë se kur kalojnë kufirin. Ndjekja e menjëhershme do të pushojë menjëherë nëse kërkohet nga Pala tjetër Kontraktuese në territorin e së cilës kryhet ndjekja e menjëhershme. Me kërkesën e policëve të ndjekjes, autoritetet kompetente do të ndalojnë personin e ndjekur në mënyrë që të zbulojnë identitetin e atij personi apo për të privuar atë nga liria.

Neni 5

Kufizimet hapësinore dhe kohore për ndjekje të menjëhershme

Ndjekje e menjëhershme do të kryhet si vijon:

- (1) Në kuadër të zonës nga vija kufitare prej 10 km në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese dhe brenda një periudhe 60 minutash nga momenti i kalimit të kufirit shtetëror.
- (2) Në rastet e ndjekjes së menjëhershme, kufiri shtetëror (toka) mund të kalohet në çdo vend dhe çdo kohë.

Neni 6

Ndjekja e menjëhershme ndërkuftare dhe privimi i lirisë së personave të ndjekur

Ndjekja e menjëhershme ndërkuftare duhet të kryhet sipas kushteve të mëposhtme:

- (1) Zyrtarët Policorë për ndjekje duhet të respektojnë dispozitat e këtij Protokoll, legjislacionin nacional të shtetit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është kryer ndjekja e menjëhershme, ata duhet të respektojnë udhëzimet e dhëna nga autoritetet kompetente lokale;
- (2) Ndjekja do të bëhet nga toka;
- (3) Hyrja në shtëpi private dhe vendet jo të qasshme për publikun duhet të ndalohet për zyrtarët policor që kryejnë ndjekjen e menjëhershme në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese;
- (4) Në hapësirat operative dhe të biznesit të qasshme për publikun mund të futen gjatë orarit të punës;
- (5) Zyrtarët Policor të ndjekjes duhet të njihen lehtë, qoftë nga uniforma ose shiriti ose nga pajisje (aksesorë) të ngjitura në automjetet e tyre (distinktiv i shërbimit, pulovër pa mëngë me mbishkrim POLICIA/POLICIA KUFITARE, shiritat me të njëjtin mbishkrim, dritë blu rotative, sirenë, fjalët POLICIA/POLICIA KUFITARE e shkruar në automjete, regjistrimet e tabelave të veturës me mbishkrim POLICIA/POLICIA KUFITARE);
- (6) Automjetet e përdorura nga zyrtarët policor të njërit nga Palët Kontraktuese do t'i nënshtrohet të njëjtës rregullore të trafikut të detyrueshëm për zyrtarët policor të Palës tjetër Kontraktuese. Kjo do të vlejë edhe për shfrytëzimin e të drejtave të veçanta dhe të drejtave prioritare. Palët Kontraktuese do të informojnë njëri-tjetrin sa i përket rregullimit të tyre përkatës ligjor;
- (7) Zyrtarët Policorë të Ndjekjes mund të mbajnë armë të shërbimit; përdorimi i saj do të lejohet vetëm në rastet e arsyeshme të vetëmbrojtjes;
- (8) Nëse nuk është kërkuar ndërprerja e ndjekjes së menjëhershme dhe nuk është e mundur të përfshihen Autoritetet lokale Kompetente në kohë, zyrtarët Policor

të Ndjekjes do ta kapin personin e ndjekur në përputhje me dispozitat e legjislacionit Nacional të shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

- (9) Sapo personi i ndjekur është privuar nga liria me qëllim të transferimit të tij/saj tek autoritetet kompetente atëherë ai apo ajo mund të kontrollohen për arsye sigurie. Objektet e gjetura tek personi mund të sekuestrohen përkohësisht deri sa të arrijnë zyrtarët e autoriteteve kompetente të palës tjetër. Gjatë transferimit, mund të përdoren edhe prangat;
- (10) Pas çdo operacioni, zyrtarët e njëkës policorë do të paraqitën para autoriteteve kompetente të palës në territorin e të cilës kanë kryer operacionin dhe të raportojnë lidhur me misionin e tyre; sipas kërkesës së atyre autoriteteve, ata duhet të jenë në dispozicionin e tyre përderisa të gjitha rrethanat që lidhen me veprimin e tyre janë qartësuar në mënyrë të mjaftueshme; kjo do të vlejë edhe me rastin kur ndjekja nuk ka rezultuar me heqjen e lirisë së personit të ndjekur;
- (11) Kur kërkohet nga autoritetet kompetent të palës ku është zhvilluar ndjekja policore, autoritetet kompetente të palës prej nga vijnë zyrtarët e angazhuar në ndjekje do të ndihmojnë hetimin pas operacionit në të cilin ata morën pjesë, si dhe në procedurat gjyqësore;
- (12) Burimet teknike të nevojshme për vëzhgim mund të shfrytëzohen deri në masën e nevojshme, nëse kjo bëhet në pajtim me legjislacionin kombëtarë të palës në territorin e të cilës është duke u zhvilluar ndjekja. Autoritetet kompetente duhet të njoftohen për mjetet teknike të cilat janë duke u përdorur.

Neni 7

Procedurat pas privimit nga liria

- (1) Një person i privuar nga liria nga autoritetet kompetente do të merret në pyetje, pavarësisht kombësisë së tij/saj. Rregullat relevante nga legjislacioni kombëtarë do të zbatohen në mënyrën mutatis mutandis.
- (2) Nëse personi nuk ka status të kombësisë të palës në territorin e të cilës ai/ajo është privuar nga liria, atëherë ai/ajo do të lirohet brenda gjashtë (6) orëve prej që ka ndodhur arrestimi, por jo në periudhën në mes të mesnatës 00:00 dhe orës 09.00 para mesditës, përveç në rastet kur autoritetet kompetente kanë pranuar më herët kërkesën në cilëndo formë për privimin e përkohshëm të tij/saj nga liria për qëllim të ekstradimit.
- (3) Kërkesa e parë për ekstradim mund të jepet në cilëndo formë.
- (4) Nëse kërkesa për ekstradim është në mënyrë verbale, atëherë ajo duhet të konfirmohet me një kërkesë me shkrim në mënyrë të menjëhershme dhe jo më vonë se pas gjashtë orëve.
- (5) Sendet që i bartë personi që është duke u ndjekur dhe ato që rrjedhin nga vepra kriminale do të konfiskohen në pajtim me legjislacionin e vendit në territorin e të

cilit ai person është privuar nga liria. Procedura do të ekzekutohet nga autoritetet kompetente të vendit në territorin e të cilit është gjetur.

Neni 8

Kërkimi për arsye të sigurisë

Përveç nëse specifikohet ndryshe nga legjislacioni kombëtarë, kontrolli që bëhet për arsye të sigurisë sipas këtij protokoll do të përfshihet kontrolli i sigurisë së një personi, të sendeve të tij/saj dhe automjeti, që ka për qëllim të përcaktojë nëse personi është i armatosur apo ka në posedim sende të tjera të rrezikshme. Kontrolli për arsye të sigurisë do të kryhet drejtpërdrejt, që nënkupton se kontroll me dorë apo me mjete teknike.

Neni 9

Të drejtat dhe autorizimet e zyrtarëve të angazhuar në ndjekje

Nëse brenda bashkëpunimit në saje të këtij Protokoll, zyrtarët zhvillojnë ndjekjen në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese, ata nuk do të kenë autorizime zyrtare përveç kur parashikohet ndryshe nga ky Protokoll. Në zbatimin e të gjitha dispozitave, ata janë të obliguar të respektojnë legjislacionin kombëtarë të shtetit të palës tjetër kontraktuese. Zyrtarët do të jenë të autorizuar për të:

- (1) veshur uniformë, armë të shërbimit dhe pajisje tjera policore;
- (2) përdorimi i armëve të tyre në raste të vetëmbrojtjes së arsyeshme;
- (3) për ta privuar personin nga liria brenda kohës së nevojshme në pajtim me këtë Protokoll;
- (4) kontrollojnë personin për arsye sigurie, sendet e tij / saj dhe automjeteve sipas këtij protokoll;
- (5) hyrja në territorin e shtetit të Palës tjetër me shenjën dalluese (distinktivi) që përmban një fotografi dhe nënshkrim duke qëndruar për sa kohë është e nevojshme për të përmbushur detyrën e tyre sipas këtij Protokoll;
- (6) përdorimi i gjitha automjeteve për operacione ndërkuftare;
- (7) përdorin mjetet teknike në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese të nevojshme për zbatimin e masave sipas këtij protokoll dhe të pranueshme si për legjislacionin kombëtar të asaj Pale Kontraktuese.

Neni 10

Përgjegjësia

Nëse zyrtarët e Palës Kontraktuese gjatë kryerjes së detyrave të ndjekjes së menjëhershme në territorin e Palës tjetër Kontraktuese i shkaktajnë dëm në kuadër të bashkëpunimit sipas këtij Protokoll, secila Palë Kontraktuese do të paguajë dëmin sipas legjislacionit kombëtar të asaj Pale Kontraktuese.

Neni 11

Statusi ligjor i zyrtarëve sipas ligjit penal

Zyrtarët Policor që kryejnë detyrat e ndjekjes emergjente në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me këtë Protokoll do të kenë të njëjtin status ligjor për vepra penale të kryera kundër tyre ose nga ana e tyre sikurse Zyrtarët Policorë të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 12

Mbrojtja e te dhënave personale

Kur grumbullojnë, procedojnë dhe ruajnë të dhënat personale për realizimin e dispozitave të këtij Protokoll, palët kontraktuese do të aplikojnë nenet 11 dhe 12 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Kosovës, dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim policor.

Neni 13

Implementimi dhe amendamenti i Protokollit

Palët Kontraktuese do të monitorojnë zbatimin e këtij Protokoll dhe nëse është e nevojshme, të hartojë ndryshimet e duhura.

Me qëllim të përmirësimit të zbatimit të këtij Protokoll, Palët kontraktuese do të planifikojnë dhe të kryejnë ushtrime të përbashkëta për ndjekjet e menjëhershme ndërkufitare.

Neni 14

Shpenzimet

Secila Palë Kontraktuese do t'i bartë shpenzimet e krijuara nga autoritetet e tyre përkatëse kompetente gjatë zbatimit të këtij Protokoll në përputhje me legjislacionin e vet kombëtar.

Neni 15

Shtojcat

Shtojcat paraqesin pjesën përbërëse të këtij Protokoll, përkatësisht:

- Lista e veprave penale për të cilat bëhet ndjekja e menjëhershme (Shtojca 1);
- Formularin e Njoftimit për Ndjekjen e Menjëhershme/ Ndërkufitare (Shtojca2);
- dhe
- Informatat kontaktuese (Shtojca 3).


Neni 16

Dispozitat përfundimtare

- (1) Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij,
- (2) Ky Protokoll mund të ndryshohet dhe plotësohet me pëlqimin e përbashkët të Palëve Kontraktuese. Ndryshimet dhe plotësimet hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni.
- (3) Secila nga Palët Kontraktuese mund të kërkojë ndërprerjen e njëanshme të këtij Protokollit. Përfundimi i Protokollit do të bëhet efektiv 30 ditë pas marrjes së njoftimit për këtë qëllim.
- (4) Çdo mosmarrëveshje që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i këtij Protokollit do të zgjidhet me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Palëve Kontraktuese ose nëpërmjet kanaleve diplomatike.


Nënshkruar më 4.12.2017, në Shkup, Maqedoni në dy kopje origjinale, secila prej tyre në gjuhën Shqipe, Maqedonase, Serbe dhe Angleze. Secili tekst duhet të jetë njësoj i vlefshëm. Në rast të ndryshimeve në interpretimin e këtij protokollit, teksti anglisht do të mbizotërojë.

**Për Ministrinë e Punëve të Brendshme
të Republikës së Maqedonisë**



Flamur Sefaj
Ministër

**Për Ministrinë e Punëve të Brendshme
të Republikës së Kosovës**



Oliver Spasovski
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër

Lista e veprave penale kur ndodh ndjekja menjëhershme;

1. Vrasje;
2. Veprat penale të ndërlidhura me terrorizmin
3. Veprat penale që lidhen me integritetin seksual;
4. Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm;
5. Falsifikim i parave apo i letrave me vlerë;
6. Vjedhje e rëndë, vjedhje me arme (vjedhje grabitqare) ose grabitje;
7. Shantazhi;
8. Privim i kundërligjshëm nga liria (nëse ndodhin pasoja vdekjeprurëse);
9. Arratisje e personit të privuar nga liria;
10. Trafikimi i qenieve njerëzore, migrimi legal dhe veprat tjera të ndërlidhura me trafikimin e qenieve njerëzore;
11. Trafikimi i lëndëve narkotike apo prekusorët e tjerë;
12. Veprat penale lidhura me prodhimin, mbajtjen dhe trafikimin ilegal të armëve, eksplozivëve, materialeve bërthamore, radioaktive, biologjike dhe kimike;
13. largimi nga vendi i aksidentit që ka rezultuar në vdekje apo lëndim trupor të një ose disa personave;
14. Fshehja dhe mbështetja e kryerësve të gjitha këtyre veprave penale

- FORMULARIN E NJOFTIMIT PËR NDJEKJEN E MENJËHERSHME/
NDËRKUFITARE

REPUBLIKA E MAQEDONISE
NINISTRIA E PUNEVE TE
BRENDESHME
BYROJA PER SIGURI PUBLIKE
Rr. Dimce Mircev. N.9, Shkup
Tel: +389 2/3143-170
Faksi: +389 2/3142-230

REPUBLIKA E KOSOVES
MINISTRIA PER PUNE TE BRENDSHME
DREJTORIA E PERGJITHESHME E POLICISE SE
KOSOVES
Rr.Luan Haradinaj, Prishtine
Tel: +381 (0) 542 127

I ADRESUARI

Organi Kompetent i _____ Palës përmes kësaj njofton
autoritetin kompetent të _____ Palës për:

| | |
|--------------------------|--|
| <input type="checkbox"/> | <p><u>Ndjekja e nxehte/emergjente ndërkufitare (neni 4, paragrafi 1)</u> Personi i nxënë në kryerjen e veprës penale për të cilën parashihet dënimi me burgim në kohëzgjatje Shtojca I, ose personi i nxënë në aktin e pjesëmarrjes në kryerjen e një vepre të tillë penale ose personi që ndiqet penalisht për kryerjen e veprave të tilla penale.</p> |
| <input type="checkbox"/> | <p><u>Ndjekja e nxehte/emergjente ndërkufitare (neni 4, paragrafi 2)</u> Person i arratisur nga paraburgimi ose përderisa duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë për veprën penale nga paragrafi 1.</p> |
| <input type="checkbox"/> | |

Data: _____ Vendi: _____

Lëvizja / Drejtuar në drejtim:

Personi:

Mbiemri dhe emri: _____
Data e lindjes: _____
Adresa: _____

Rreziqet në rastin:

- I njohur për përdorimin e dhunës
 Rreziku nga vetë shkaktimi i lëndimeve
 I armatosur
Përshkrim më i detajuar:
 Mund të konstatohet në mënyrë të sigurt se personi nuk është i armatosur

Automjeti i kryesit:

Prodhimi: _____
Lloji: _____
Numri tabelave të regjistrimit: _____
Pasagjerët (jo): _____

Ekipi i vëzhgimit / personat që kryejnë ndjekjen:

Bashkëbiseduesi: _____
Telefoni celular Nr _____
Kodi: _____
Radio kanali (UKV): _____

INFORMATAT KONTAKTUESE
Organet kompetente për zbatimin i këtij Protokolli

Për palën maqedonase:

1. **Ministria e Punëve të Brendshme**
Byroja për Siguri Publike
Rr. Dimce Mircev Nr.9, 1000 Shkup
Tel: +389 2 / 3143-170
Fax: +389 2 / 3142-230
2. **Spektori për Çështje Kufitare dhe Migracion**
Rr. Dimce Mircev no.9, 1000 Shkup
Tel: +389 2/ 3238-034, +389 72/334-031
Fax: +389 2/3143-335
e-mail: mvr_sgrm@moi.gov.mk
3. **Qendra Rajonale për Çështje Kufitare – Veri**
MTV Building, 5th floor, 1000 Shkup
Tel: +389 2/ 3238-040; +389 72/228-626
Fax: +389 2/3238-039
4. **Stacioni Policor i Kontrollimit Kufitar – “Dolno Blace”**
Tel: +389 2/3214-018, +389 72/228-565
Fax: +389 2 3143-957
5. **Stacioni Policor i Kontrollimit Kufitar – “Jazinec”**
Tel: +389 44/363-092, +389 72/228-571
Fax: +389 44/363-092

Për palën kosovare:

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë**

Qendra Operative Komunikuese

Rr. Luan Haradinaj – Prishtinë

Tel. fix. +381-(0)38 542127, Mobil. +377 -(0)44 – 500-404.

Fax. +381-(0)38-5080-1413.

2. Drejtoria Rajonale e Lindjes-Policia Kufitare

Qendra Operative Komunikuese

e-mail: lindjaqkr@kosovopolic.com

Tel: +381(0) 290 380 154

3. Pika Kufitare Hani i Elezit

e-mail: pkk.haniielezit@kosovopolic.com

Tel: + 381(0) 290 385 013

4. Pika Kufitare Gllboçicë

e-mail: 9kk.gllboqice@kosovopolic.com

5. Togjet Patrulluese Kufitare – Regjioni i Lindjes

e-mail: togjet.patrulluesek@kosovopolic.com

Tel: +381(0)290 385 260

6. Drejtoria Rajonale e Perëndimit-Policia Kufitare-Gjakovë

e-mail: Perendimiqr@kosovopolic.com ,

Tel: +381(0)390 – 320 287 tel- V-sat 5900 & 5928

Fax: +381(0)390-320 287 5900